



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

**RAPORTI
I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
“MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË PROKURORIVE
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
PËR VITIN 2021”**

Tiranë, 16 Maj 2022

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE	3
I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM, GJENDJA, PROGRESI, PROBLEMATIKAT DHE MBËSHTETJA QË KËRROHET	4
II. VEPRIMTARIA E PROKURORIVE, PROBLEMATIKAT DHE ÇËSHTJET QË KËRKOJNË VËMENDJE.....	6
1. Veprimtaria e prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm	6
i) Përformanca e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.....	7
- <i>Procedime të regjistruara/procedime të përfunduara (Niveli i efikasitetit).....</i>	7
- <i>Procedime në ndjekje/procedime të përfunduara (Shkalla e mbingarkesës në prokurori).....</i>	9
- <i>Ngarkesa e prokurorëve.....</i>	10
2. Veprimtaria e prokurorive të apelit me juridiksion të përgjithshëm	14
i) <i>Performanca e prokurorive pranë gjykatave të apeleve</i>	14
- <i>Procedime të regjistruara/procedime të përfunduara (Niveli i efikasitetit)..</i>	14
- <i>Ngarkesa e prokurorëve të apeleve.....</i>	15
3. Veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme	17
4. Monitorimi, gjendja, problematikat dhe mbështetja që kërkohet	19
III. BASHKËPUNIMI DHE MBËSHTETJA	20
1. Bashkëpunimi me SPAK.....	21
2. Bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë.....	21
3. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese.....	21

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zonja e zotërinj anëtarë,

Viti që kaluam rezultoi të ishte sërish i vështirë për shkak të kohëzgjatjes së pandemisë, e cila ndikoi dhe krijoi probleme edhe në funksionimin e sistemit të prokurorisë, por edhe për shkak të largimeve të prokurorëve nga detyra për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar që krijoi mjaft vakanca në system. Megjithatë prokurorët dhe strukturat administrative e mbështetëse të prokurorisë e përballuan këtë situatë. Vlerësoj se janë arritur rezultate në një sërë objektivash në fokusin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme, nëpërmjet masave administrative dhe procedurale institucionale, siç janë miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrja e zbatimit tyre, me synim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit bazuar në një kuadër normativ të unifikuar dhe të konsoliduar në veprimtarinë institucionale, ashtu dhe nëpërmjet miratimit dhe vijimit të zbatimit të akteve të përbashkëta me disa institucione dhe agjenci ligjzbatuese ndërvepruese për të rritur kapacitetet institucionale e profesionale dhe efikasitetin e bashkëpunimit ndërinstytucional, ku veçojmë:

- Masat e marra për ndjekjen e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021, nëpërmjet, si hartimit të Planit Veprimit për ndjekjen e kërkesave të kësaj rezolute, i miratuar me urdhrin nr.78, datë 09.07.2021, ashtu dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, me efekte në përmirësimin e mbarëvajtjes së punës në administratën e prokurorive të shkallës së parë dhe të apelit me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e rritjes së performancës dhe efikasitetit në organizimin, drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës në çdo prokurori, forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në bashkëpunim me projektin PAMECA V dhe projektin EURALIUS V, si dhe rritjen e efikasitetit të bashkëpunimit dhe koordinimit, ndërinstytucional në nivel qendror e vendor me miratimin dhe zbatimin e urdhërit të përbashkët me disa institucione të përfshira në memorandumin e bashkëpunimit, ashtu dhe vijimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me fillimin e funksionimit dhe hapjen e zyrës të prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust në Hagë.

- Masat e marra për ndjekjen e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave datë 2.06.2021, nëpërmjet, si miratimit dhe zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.4/2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, ashtu dhe Planit Veprimit “Për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021” i miratuar me urdhërin nr.79/2021, me efekte në orientimin e politikave institucionale për ndjekjen e unifikuar të rekomandimeve prioritare të KM nëpërmjet masave administrative dhe procedurale të përcaktuara për drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe në drejtim të riorganizimit të brendshëm, koordinimit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale prioritare të rekomanduara, dhe mbikëqyrjen në vazhdimësi të ecurisë së tyre për garantimin e pavarësisë së prokurorëve, forcimin e ligjshmërisë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe rritjen e bashkëpunimit e koordinimit ndërinstytucional.

- Masat e marra në drejtim të forcimit të pavarësisë së prokurorëve, mirëfunksionimit të zyrave të prokurorive dhe rritjes së efikasitetit të punës në çdo prokurori, nëpërmjet mbikëqyrjes të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm me nr.12/2020;

- Masat e marra në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale në luftën ndaj pastrimit të produkteve të veprës penale, krimit financiar dhe goditjes së aseteve kriminale, duke bashkërenduar punën dhe koordinuar në nivel qendror e vendor me të gjithë institucionet ligjzbatuese të përfshira, ashtu dhe në kryerjen e trajnime të përbashkëta ndër-institucionale;

- Masat e marra për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes me Policinë e Shtetit, për mënyrën e trajtimit të një pjese të materialeve kallëzuese, e shoqëruar edhe me udhëzimin përkatës që hyri në fuqi me 1 janar 2021, për t'i dhënë zgjidhje një problemi të mbartur prej vitesh, lidhur me cilësinë e materialeve referuese;

- Masa e marra që synojnë përmirësimin e punës në prokurori në drejtim të respektimit të të drejtave të viktimave të krimit, veçanërisht ato të dhunës në familje e grupeve vulnerabël dhe të miturve në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, nëpërmjet mbikëqyrjes të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.17/2020 dhe miratimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.8/2021, si dhe organizimin e tryezave të diskutimeve dhe pjesëmarrjes në trajnime, masa këto që do të vijojnë të jenë në fokusin tonë edhe në vitin 2022.

- Në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të kërkesave të rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, ashtu dhe të objektivave të synuara në udhëzimet e përgjithshme dhe Planet e Veprimit, ashtu si e theksova dhe në hyrje të këtij raportimi, jemi të ndërgjegjshëm se realizimi i tyre është vështirësuar, si për shkak se në të gjithë nivelet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm ka vijuar krijimi i vakancave të përkohshme dhe të përhershme, si për shkak të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, ashtu dhe për shkak të vijimit të gjendjes së pandemisë Covid 19 dhe përgjatë vitit 2021.

Në mënyrë të përmbledhur aspektet e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021, pasqyrohen më në detaje, sa më poshtë:

I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM, GJENDJA, PROGRESI, PROBLEMATIKAT DHE MBËSHTEJA QË KËRROHET.

Përgjatë vitit 2021, për shkak të vakancave numri i përgjithshëm faktik i prokurorëve ka qenë 205, tregues që evidenton se 116 prokurorë i mungojnë prokurorive me juridiksion të përgjithshëm. Gjendja e numrit faktik të prokurorëve sipas nivelit të prokurorive ka qenë: 177 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, ose 110 prokurorë më pak për shkak të vakancave, 16 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit ose 10 prokurorë më pak për shkak të vakancave, dhe 9 prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme ose 8 prokuror më pak për shkak të vakancave. Krahasuar vetëm me vitin 2019¹ shifra në ulje në numrin faktik në total është përkatësisht prej 33,66 % e prokurorëve.

¹ Numri faktik i prokurorëve në janar 2019 ka qenë 309, përkatësisht 276 në shkallë të parë, 21 në prokuroritë e apeleve dhe 12 në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në kuadrin e përmirësimit të rregullave standard në organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, me datë 1 janar 2021 hyri në fuqi urdhëri nr.164/2020 i Prokurorit të Përgjithshëm, për miratin e dy rregulloreve standard, për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, mbi bazën e të cilëve drejtuesit e prokurorive sipas nivele kanë nxjerr rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e secilës strukturë që kryen funksione procedurale dhe administrative sipas strukturës standarde², me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të çdo strukture, për të siguruar efikasitet në organizimin, drejtimin, koordinimin, dhe mbikëqyrjen apo monitorimin e punës në çdo prokurori.

Udhëzime të përgjithshme dhe akte normative me rëndësi në aspektin organizativ dhe funksional të miratuara në vitin 2021 mund të përmendim: -udhëzimi i përgjithshëm nr.2, datë 31.03.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”; -udhëzimi i përgjithshëm nr.4, datë 09.07.2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”; -udhëzimi i përgjithshëm nr.6, datë 23.07.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020 “Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”; -udhëzimi i përgjithshëm nr.10, datë 30.12.2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimi me institucionet kushtetuese e ligjore”; -urdhëri nr.92 datë 30.07.2021 “Për përdorimin e regjistrit elektronik dhe përfitim të statistikave për çështje të pastrimit të parave në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”; si dhe akte të tjera në funksion të garantimit të informacionit “Sekret Shtetëror”, siç janë dhe; -Urdhri nr.105, datë 30.09.2021 “Për krijimin e Strukturës së Sigurisë në zbatim të VKM nr. 542, datë 25.7.2019 “Për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI)” dhe -urdhri nr.111, datë 15. 10.2021 “Për caktimin e Strukturës së Sigurisë”.

Në kushtet e një situatë kritike vazhduese të mungesës së kapaciteteve funksionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm të krijuar nga vakancat e prokurorëve në procesin e vetingut, Prokurori i Përgjithshëm në vijim të punës së nisur për shmangien e efekteve të krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar në sistemin e prokurorisë, me shkresën nr.1434, datë 24.09.2021 i ka kërkuar Komisionit të Policisë Gjyqësore rritjen në 250 të numrit organik të oficerëve të policisë gjyqësore në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe kryerjen e procedurave për emërimin e tyre sipas nevojave në disa prokurori. Ndërkohë Komisioni ka caktuar numrin e përgjithshëm prej 250 oficerë të Policisë Gjyqësore të Seksioneve të Policisë Gjyqësore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si dhe pas kryerjes së procedurave të konkurimit është mundësuar emërimi i 25 oficerë të policisë gjyqësore në

² Neni 20 në lidhje me nenin 38 pika 2 shkronja “e” e ligjit nr.97/2016;

seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për të lehtësuar dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve në përballimin e volumit të punës në rritje, në ato prokurori të cilat aktualisht janë të mbingarkuara me kryerjen e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e çështjeve në gjykim.

Gjithashtu, krahas plotësimit të vakancave me prokurorë nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadrin e miratimit shpresojmë së afërmi të hartës së re gjyqësore jemi angazhuar për marrjen e masave që nevojiten për përmirësime në infrastrukturë nëpërmjet rritjes të kapaciteteve akomoduese me ambjente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokurori, me synim për të lehtësuar rritjen e ngarkesës dhe mbështetur veprimtarinë e prokurorëve me numër të reduktuar dhe pëmirësuar kushtet e punës, në gjithë sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.

II. VEPRIMTARIA E PROKURORIVE, PROBLEMATIKAT DHE ÇËSHTJET QË KËRKOJNË VËMENDJE.


1. Veprimtaria e prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

Raporti mbi gjendjen e kriminalitetit, ku përfshihet dhe raporti mbi ngarkesën e punës të prokurorive për vitin 2021 që i janë vënë në dispozicion këtij Këshilli, paraqesin të dhëna të hollësishme për treguesit e punës dhe ecurinë e veprimtarisë për të gjithë prokuroritë.

Në këtë raportim, vlerësojmë të ndalemi në disa tregues të performancës së prokurorive, problematikat dhe disa çështje që kërkojnë vëmendjen tuaj.

Gjatë vitit 2021, janë trajtuar 61015 materiale në shqyrtim³, që përbën një rritje prej 4,35% në krahasim me vitin 2020. Janë ndjekur gjithsej 47512 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 5,97 % në krahasim me vitin 2020, nga të cilat 28368 janë procedime penale të regjistruara, me një rritje prej 1,71 % në krahasim me vitin 2020 dhe 940 procedime penale të rifilluara, që tregon rritje prej 46,87 % në krahasim me vitin 2020. Janë mbartur në vitin 2021, 18204 procedime penale me rritje prej 11,65 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2020. Është vendosur mosfillimi i procedimit për 13503 referime dhe kallëzime penale, me ulje prej 0,94 % në krahasim me vitin 2020.

³ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2021 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2021; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2021.



Gjatë vitit 2021 janë përfunduar 25688 çështje që përbën ulje prej 1,84 % të çështjeve të përfunduara krahasuar me vitin 2020, prej të cilave: 40,86 % janë dërguar për gjykim, 22,62 % janë pushuar, 33,72 % janë pezulluar dhe 2,8 % janë transferuar në prokuroritë kompetente.

Janë dërguar në gjykatë për pushim 4686 çështje ose me rritje 0,83% krahasuar me vitin 2020, prej të cilëve 34,07 % janë pushuar për mungesë fakti. Nga të dhënat rezulton se për 144 çështje gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ose me ulje 38,19 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në 6 çështje vendosi kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës, krahasuar me 5 vendime të tilla në vitin 2020.

Janë dërguar në gjykatë për kalimin për gjykim 10507 çështje me akuzë ndaj 12353 të pandehurve. Krahasuar me vitin 2020 rezulton një rritje prej 5,35 e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 7,38 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2021 janë dënuar 8371 të pandehur dhe për 144 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm ose krahasuar me vitin 2020 me rritje 4,35 % e numrit të pandehur të dënuar dhe ulje 5,26 % e numrit të pandehurve të deklaruar të pafajshëm.


i) Përformanca e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.

-Procedime të regjistruara/procedime të përfunduara⁴ (Niveli i efikasitetit)

Të dhënat me numrin e procedimeve të regjistruara për secilën prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë, përgjatë vitit 2021, janë në paraqitjen grafike më poshtë:


⁴ Koment: Në kuadrin e këtij vlerësimi të performancës, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2021, evinton si tregues potencial volumin e procedimeve të regjistruar të prokurorive, ndërsa treguesi potencial i çështjeve të përfunduara konsiderohet i përmbushur për numrin e procedimeve/çështjeve të përfunduara brenda këtij viti. Të dhënat për “procedimet e regjistruara” evidentojnë ngarkesën e prokurorive përkatëse, tregues me të cilin lidhet pritshmëria e publikut për punën e secilës prokurori. Ndërsa, indikatorin “procedime të përfunduara” tregon kapacitetin e secilës prokurori për të përfunduar brenda afateve ligjore në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore.

Regjistruar 2021



Nga analiza në përqindje e raportit të çështjeve të përfunduara me procedimet e regjistruara në secilën prokurori për vitin 2021 evidentohet performancë më e ulët në Prokuroritë e rretheve gjyqësor Sarandë, Lushnje, Gjirokastër, Kavajë, Tropojë me tregues të performancës nën 70 %, etj, ndërsa performanca më e lartë evidentohet në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Pukë, Kukës, Mat e Fier, me tregues të performancës mbi 100%.


Raporti i procedimeve të përfunduara me procedimet e regjistruara



Ky raport evidenton performancën lidhur me efikasitetin e punës së prokurorive përgjatë vitit 2021, ku pasqyrohet gatishmëria dhe mundësia e secilës prokurori për të përfunduar brenda vitit procedimet e regjistruara. Në këtë vështrim vihen re përqindjet e efikasitetit, siç janë, kur vlera është më e vogël se 100% tregon se prokuroria nuk ka arritur të përfundojë të gjitha procedimet e regjistruara, kur vlera është 100% tregon se prokuroria ka qenë plotësisht efikase në përfundimin/zgjidhjen e procedimeve të regjistruara, dhe kur vlera është më e lartë se 100% tregon se prokuroria ka arritur të përfundojë më shumë procedime se sa ka regjistruar, duke ulur dhe numrin e procedimeve të mbartura nga viti paraardhës.


-Procedime në ndjekje/procedime të përfunduara⁵ (Shkalla e mbingarkesës në prokurori)

Të dhënat sipas secilës prokurori për vitin 2021 që tregojnë totalin (volumin e punës) janë: -18192 çështje të mbartura, -28349 çështje të regjistruara, -934 çështje të rifilluara dhe -13501 procedime të mosfilluara, dhe paraqitjen në grafikun më poshtë.



Nga analiza në përqindje e raportit të procedimeve të përfunduara me çështjet e mbartura dhe procedimet e regjistruara, etj (procedimet në ndjekje) në secilën prokurori për vitin 2021, evidentohen treguesit si: nga performanca më e ulët që konstatohet në prokurorinë e rrethit gjyqësor Sarandë, ku janë përfunduar 27 % e procedimeve në ndjekje, e më pas vijon me rritje në rrethet Gjirokastër, Berat, Dibër, Lushnje etj, dhe vijon me në performancën më të lartë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, ku janë përfunduar 97 % e procedimeve në ndjekje në atë prokurori dhe që vijon në rend zbritës në rrethet Kukës, Pukë, Kurbin etj.

⁵ Koment: Në këtë tregues të performancës, referuar numrit të procedimeve/çështjet të mbartura dhe procedimeve të regjistruara (procedimet/çështjet në ndjekje), parashtroj vlerësimin e efikasitetit që do t'i duhej prokurorëve në vitin 2022, për të përfunduar procedimet e mbartura dhe procedimet e regjistruara të reja, nëse trendi i volumit të punës dhe numrit të prokurorëve do të ishte në të njëjtat shifra.




Raporti më sipër evidenton se prokuroritë me përqindje nën 50 % të çështjeve të përfunduara brenda vitit 2021, dhe jo vetëm, me të njëjtin numër faktik të prokurorëve, vlerësojmë se mund t’ju duhej më shumë se 1 vit efikasitet pune për të përfunduar të gjitha çështje në ndjekje, pa regjistruar procedime të reja, rrethana që evidentojnë nevoja emergjente për të plotësuar vakancat, për të normalizuar veprimtarinë në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Sarandë, Gjirokastrë, Berat, Dibër, Lushnje, Tropojë, Kavajë e Shkodër.

-Ngarkesa e prokurorëve⁶.

Të dhënat për mesataren e çështjeve të përfunduara për çdo prokuror sipas numrit faktik të prokurorëve përgjatë vitit 2021, sipas prokurorive janë në paraqitjen grafike, si më poshtë:

⁶ Koment: Ky tregues/indikator që përfaqëson numrin mesatar të procedimeve/çështjeve të përfunduara nga një prokuror brenda një viti, e përlogaritur me numrin e procedimeve/çështjeve të ndjekura (mbartura dhe procedimeve të regjistruara) gjatë vitit 2021 në raportë me numrin e prokurorëve të angazhuar gjatë këtij viti, pa u trajtuar niveli/shkalla e vështirësive sipas natyrës së çështjeve për mungesë të treguesve, evidentohet se mesatarja e çështjeve të përfunduara për çdo prokuror sipas numrit faktik të prokurorëve është sipas prokurorive.




Ngarkesa mesatare për çështjet e përfunduara nga prokurorët në vitin 2021 janë: -më e larta 343 çështje të përfunduara në prokurorinë e rrethit gjyqësor Kukës, dhe -më e ulta 87 çështje të përfunduara në prokurorinë e rrethit gjyqësor Pukë, rrethana që evidentojnë nevojën për të rivlerësuar numrin faktik të prokurorëve në ato prokurori ku numri mesatar i ngarkesës për prokuror është i lartë dhe me tendencë në rritje të treguesve të procedimeve në ndjekje, me synim unifikimin e ngarkesës së prokurorëve sa më afër nivelit mesatar në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.



-Në analizë të performancës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, ku evidentohet përqindja që zënë procedimet e regjistruara dhe procedimet e mbartura në volumin e punës, përqindja që zë raporti i procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje, dhe procedimeve të përfunduara me procedimet e regjistruara, të dhënat janë si vijon:


	<i>Raporti i procedimeve të regjistruar në totalin e volumit</i>	<i>Raporti i procedimeve të mbartura në totalin e volumit</i>	<i>Raporti i procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje</i>	<i>Raporti i procedimeve të përfunduara me procedimet e regjistruara</i>	<i>Mesatarja për prokuror çështje ndjekura (numri faktik)</i>
Berat	35%	45%	33%	74%	888(rritur)
Dibër	35%	37%	35%	82%	392 (rritur)
Durrës	41%	29%	55%	95%	286 (rritur)
Elbasan	52%	37%	58%	101%	220 (rritur)

<i>Fier</i>	48%	42%	54%	102%	247 (rritur)
<i>Gjirokastrë</i>	35%	37%	31%	64%	465 (ulur)
<i>Kavajë</i>	48%	19%	46%	64%	381 (rritur)
<i>Korçë</i>	40%	35%	52%	97%	422 (rritur)
<i>Krujë</i>	45%	41%	50%	96%	307 (ulur)
<i>Kukës</i>	58%	20%	93%	124%	478 (rritur)
<i>Kurbin</i>	47%	21%	64%	100%	483 (rritur)
<i>Lezhë</i>	63%	21%	60%	81%	386 (rritur)
<i>Lushnjë</i>	52%	23%	43%	62%	586 (rritur)
<i>Mat</i>	59%	5%	97%	117%	143 (ulur)
<i>Përmet</i>	61%	39%	54%	89%	231 (rritur)
<i>Pogradec</i>	53%	28%	51%	77%	323 (rritur)
<i>Pukë</i>	27%	8%	90%	246%	265 (rritur)
<i>Saranda</i>	35%	41%	27%	59%	705 (rritur)
<i>Shkodër</i>	46%	36%	47%	95%	354 (rritur)
<i>Tiranë</i>	50%	23%	63%	95%	352 (rritur)
<i>Tropojë</i>	54%	15%	44%	66%	523 (rritur)
<i>Vlorë</i>	44%	15%	55%	93%	393 (rritur)

-Raporti i numrit mesatar të procedimeve të regjistruara dhe procedimeve në ndjekje sipas numrit organik dhe faktik të prokurorëve sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë paraqitet në vijim:







Mesatarja e çështjeve të regjistruara gjatë vitit 2021 në raport me numrin faktik të prokurorëve në rrethet gyqësore, 28349/177, rezulton të jetë në rang vendi 160 procedime penale për prokuror. Ky duhet të ishte treguesi bazuar në të cilin do të duhej të ishte edhe shpërndarja e balancuar e numrit të prokurorëve në rang vendi. Por, nga të dhënat rezulton se rreth kësaj mesatare afrohen prokuroritë në rrethet Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Përmet e Krujë, ku mesatarja e regjistrimeve të reja varion nga 141 në 171 procedime. Kanë një raport ndjeshëm të disfavorshëm prokuroritë në rrethet Kurbin, Lezhë, Kukës, Tropojë, Lushnje e Berat ku shifrat variojnë nga 227-314, ndërsa rezultojnë me një mesatare të ulët rrethet Durrës, Elbasan, Mat dhe Pukë, ku mesatarja varion nga 118-36 procedime penale.

Përtej kësaj shifre, nisur nga probleme të akumuluar në vitet e kaluara, nëse do të llogarisim ngarkesën faktike duke shtuar procedimet e mbartuara, situata rezulton shumë e rënduar në rrethet Berat, Sarandë, Lushnje, Tropojë, Kurbin, Kukës, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Dibër, Lezhë me një mesatare të ngarkesës nga 392-888 procedime për çdo prokuror. Ngarkesa më e ulët mbetet në rrethet Pukë, Fier, Përmet, Elbasan, Mat, ku varion nga 286-143 procedime.

2. Veprimtaria e prokurorive të apelit me juridiksion të përgjithshëm

i) Performanca e prokurorive pranë gjykatave të apeleve

- Procedime të regjistruara/procedime të përfunduara (Niveli i efikasitetit).

Në kuadrin e vlerësimit të performancës së prokurorive të apelit, treguesi “gjithsejt çështje themeli dhe masa sigurimi” që evidenton çështjet e themelit dhe masat e sigurimit të regjistruara përgjatë vitit 2021 sipas prokurorive të apeleve, dhe treguesi “gjithsejt kërkesa për themel dhe masa” që evidenton numrin e çështjeve që prokurorët e apelit kanë përfunduar në gjykatën e apelit, janë paraqitur në tabelen më poshtë.

Raporti në përqindje i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara në secilën prokurori apeli për vitin 2021, evidenton treguesit, -nga performanca më e ulët 82,9% në Prokurorinë e Apelit Durrës, deri në performancën më të lartë 105,4 % në Prokurorinë e


Apelit Tiranë. Ky raport evidenton dhe efikasitetin e punës të secilës prokurori apeli brenda vitit 2021, ku pasqyrohet gatishmëria dhe mundësia e secilës prokurori për të përfunduar brenda vitit procedimet e regjistruara.

<i>2021</i>	<i>Gjithsej çështje themeli dhe masa sigurimi</i>	<i>Gjithsej kerkesa për themel dhe masa (përfshi mospranim ankimi)</i>	<i>Raporti</i>
<i>Prokuroria e Apelit Tiranë</i>	1498	1579	105,4%
<i>Prokuroria e Apelit Durrës</i>	696	577	82,9%
<i>Prokuroria e Apelit Korçë</i>	338	348	102,95%
<i>Prokuroria e Apelit Shkodër</i>	648	648	100%
<i>Prokuroria e Apelit Vlorë</i>	820	815	99,4%
<i>Prokuroria e Apelit Gjirokastrë</i>	265	267	100,75%

Në këtë vështrim, sipas tabelës më sipër, vihen re përqindjet e efikasitetit, siç janë, kur vlera është më e vogël se 100% tregon se prokuroria e apelit nuk ka arritur të përfundojë të gjitha çështjet e regjistruara, kur vlera është 100% tregon se prokuroria e apelit ka qenë plotësisht efiçase në përfundimin e çështjeve, dhe kur vlera është më e lartë se 100% tregon se prokuroria ka arritur të përfundojë më shumë procedime se sa ka regjistruar, duke ulur dhe numrin e procedimeve të mbartura nga viti paraardhës, siç janë Prokuroritë e Apeleve Tiranë e Korçë.

- Ngarkesa e prokurorëve të apeleve.

Kjo ngarkesë përfaqëson numrin mesatar të procedimeve/çështjeve të përfunduara nga një prokuror në apel brenda vitit, e përlogaritur me numrin e procedimeve/çështjeve të ndjekura (mbartura dhe procedimeve të regjistruara) gjatë vitit 2021 në raport me numrin e prokurorëve të angazhuar gjatë këtij viti, evidenton se mesatarja e çështjeve të përfunduara për çdo prokuror në apel sipas numrit faktik të prokurorëve është sipas prokurorëve në paraqitjen grafike si më poshtë:



Kjo paraqitja grafike evidenton se ngarkesa mesatare për çështjet e përfunduara nga prokurorët e apelit në vitin 2021, më e larta prej 350 çështje të përfunduara në Prokurorinë e Apelit Shkodër dhe më e ulta me prej 144 çështje të përfunduara në Prokurorinë e Apelit Durrës, rrethana që evidentojnë nevojën për të rivlerësuar numrin faktik të prokurorëve në ato prokurori ku numri mesatar i ngarkesës për prokuror është i lartë dhe me tendencë në rritje të treguesve të procedimeve në ndjekje, me synim unifikimin e ngarkesës së prokurorëve të apelit sa më afër me nivelin e ngarkesës mesatare në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të apeleve me juridiksion të përgjithshëm.

Veç sa më sipër, referuar disa treguesve të tjerë të performancës së prokurorive të apeleve, gjatë vitit 2021, evidentohet se prokurorët e apelit:

-kanë hequr dorë në 48,34 % të ankimeve të prokurorit të shkallës së parë për çështje themeli;

-kanë kërkuar në 4,21 % të kërkesave lehtësim të pozitës së të pandehurit (në 14,8 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

-kanë kërkuar në 1,01 % të kërkesave prishjen e vendimit dhe vendosjen e pushimit ose pafajësi (në 30,77 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

-kanë kërkuar në 2,02 % të kërkesave prishjen e vendimit dhe kthimi i akteve (në 42,3 % të rasteve gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit);

-gjykata ka mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë në 75,1 % të rasteve dhe kërkesën e prokurorit për rëndimin e pozitës së të pandehurit në 21,57 % të rasteve.

Gjithashtu, evidentohen edhe elementë të tjerë të treguesve të performancës së prokurorëve të apelit të shprehur në përqindje për secilën prokurori apeli, sipas treguesve në tabelen më poshtë:

<i>Hequr dorë nga</i>	<i>Hequr dorë nga</i>	<i>Miratuar</i>	<i>Miratuar</i>	<i>Miratuar</i>
<i>dorë nga</i>	<i>dorë nga</i>	<i>r</i>	<i>r</i>	<i>kërkesa</i>

	<i>apeli i prokurorit të Sh.I Themel</i>	<i>apeli i prokurorit të Sh.I për Masa Sigurimi</i>	<i>kërkesa për lënie në fuqi Themel</i>	<i>kërkesa për lënie në fuqi Masë Sigurimi</i>	<i>për rëndim pozite Themel</i>
<i>Prokuroria e Apelit Tiranë</i>	35%	46%	86%	83,7%	29%
<i>Prokuroria e Apelit Durrës</i>	8%	10%	59,24%	76%	28%
<i>Prokuroria e Apelit Korçë</i>	60%	0	71,62%	78,7%	0%
<i>Prokuroria e Apelit Shkodër</i>	37,8%	27.8%	27,8%	80%	22,5%
<i>Prokuroria e Apelit Vlorë</i>	85,1%	3,57%	3,57%	82%	11,5%
<i>Prokuroria e Apelit Gjirokastrë</i>	12%	20%	20%	93%	25%

Këto tregues evidentojnë: -në çështjet e themelit që është hequr dorë nga apelimi i prokurorit të shkallës së parë; përqindja më e lartë prej 85,1 % është në Prokurorinë e Apelit Vlorë, ndërsa përqindja më e ulët 8% është në Prokurorinë e Apelit Durrës; -në çështjet për masa sigurimi që është hequr dorë nga apelimi i prokurorit të shkallës së parë, përqindja më e lartë prej 46 % është në Prokurorinë e Apelit Tiranë, ndërsa përqindje më e ulët 0 është në Prokurorinë e Apelit Korçë; - miratimi nga gjykata i kërkesave të prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit për çështje themeli, përqindja më e lartë prej 86 % është në Prokurorinë e Apelit Tiranë, ndërsa përqindja më e ulët 3,57 % është në Prokurorinë e Apelit Vlorë; - miratimi nga gjykata i kërkesave të prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit për masë sigurimi, përqindja më e lartë prej 93 % është në Prokurorinë e Apelit Gjirokastrë, ndërsa përqindja më e ulët prej 76 % është në Prokurorinë e Apelit Durrës; - miratimi nga gjykata i kërkesave të prokurorit të apelit për rëndim pozite për çështje themeli, përqindja më e lartë prej 29 % është në Prokurorinë e Apelit Tiranë, ndërsa përqindja më e ulët 0 % është në Prokurorinë e Apelit Korçë.

3. Veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme

Në përmbushje të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, veprimtaria e Prokurorisë së Përgjithshme, përgjatë vitit 2021, ka vijuar në realizimin e misionit dhe objektivave prioritare, përmbushjen e kërkesave/rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me prioritetet e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit, si dhe të angazimeve në zbatim të disa strategjive ndërinstitucionale ku jemi të përfshirë.

3.1 Krahas veprimtarive të tjera të trajtuara në këtë raport, në përmbushje të kërkesave të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2021, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me ekspertët e projektit EURALIUS V ka përgatitur dhe me datë 30.12.2021 është miratuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.10 “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese e ligjore”. Ky

udhësim synon unifikimin e ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse dhe verifikuese nga strukturat përkatëse dhe/ose nga autoriteti i monitorimit në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, për të garantuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme, dhe si kanë ndikuar ato në efikasitetin dhe/ose efektivitetin e ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë në drejtimet e udhëzuara dhe/ose rekomanduara, si dhe për iniciimin e inspektimeve tematike në strukturat përkatëse ose hetimeve disiplinore për shkelje individuale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve sipas ligjit në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore, për të siguruar pavarësinë/autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e sistemit të prokurorisë.

Ky udhëzim i përgjithshëm përcakton rregullat për mënyrën e mbikëqyrjes të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe marrjes së informacionit nga strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme në bashkërendim me autoritetin e monitorimit/mbikëqyrjes në prokuroritë përkatëse, si dhe mënyrën e mbikëqyrjes dhe verifikimit të indicieve, informacioneve ose ankesave për problematikat apo shkeljet e konstatuara apo të pretenduara dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse në prokurori dhe me institucionet kushtetuese dhe ligjore.

3.2 Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme në ushtrimin e funksioneve kanë përfaqësuar organin e akuzës në 54 çështje pranë Gjykatës së Lartë, prej të cilave 34 gjykime themeli, ku tre janë për vendime njësuere, dhe 20 gjykime masa sigurimi, si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 5 çështje.

Ndërkohë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale janë trajtuar dhe u është dhënë zgjidhje ligjore 49 kërkesave për mosmarrëveshje për kompetencat (tokësore) mes prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

3.3 Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, përgjatë vitit 2021 janë kryer raportimet dhe informimet për institucionet kushtetuese, dërguar: Kuvendit të Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë, etj, për zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave, bazuar, si në progresin e politikave dhe masave institucionale të Prokurorisë së Përgjithshme dhe disa prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, ashtu dhe me të dhënat e treguesve kryesorë të progresit të punës së prokurorive, sipas periudhave raportuese.

3.4 Prokuroria e Përgjithshme, për të realizuar funksionet dhe detyrat kushtetuese e ligjore që ka në kompetencë dhe në kuadrin e kërkesave dhe rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe ndërkombëtare është angazhuar për normimin dhe unifikimin e veprimtarive administrative dhe funksionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, me synim garantimin e pavarësisë së prokurorëve, rritjen e efektivitetit në kryerjen e hetimeve ushtrimin e ndjekjes penale dhe ngritjen e përfaqësimit e akuzës në gjykatë, ashtu dhe për përgatitjen e projekt-akteve të përbashkëta me institucione të tjera të përfshira për rritjen e efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitucional me strukturat hetimore të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe agjensitë ligjzbatuese për rritjen e efektivitetit në veprimtarinë procedurale penale dhe në ushtrimin e funksioneve apo detyrave të tjera të parashikuara me ligj.

-Në këtë vështim, janë përgatitur e miratuar: -10⁷ udhëzime të përgjithshme, -15⁸ urdhëra normative për miratimin e planeve të veprimit dhe normimin e veprimtarive të tjera administrative apo funksionale, si dhe -inicuar e përgatitur 4⁹ marrëveshje bashkëpunimi ndërinstucionale, me synim realizimin e misionit kushtetues dhe ligjor të prokurorisë, forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e mëtejshme të efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjes dhe përfaqësimit të çështjeve dhe akuzave në gjyq, për krime të rënda e sensitive, në respektim të të drejtave të ligjshme dhe lirive personale të individit e viktimave në procesin penal, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve.

3.5 Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka kontribuar në raportimin e progresin në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve të BE-së, ku institucionalisht jemi përfshirë në disa aktivitete. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar dhe ka kontribuar në raportimin periodik të progresit në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve të Moneyval dhe planit të veprimit FATF/ICRG.

4. Monitorimi, gjendja, problematikat dhe mbështetja që kërkohet

i) Prokurori i Përgjithshëm, në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, **në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” e Kushtetutës, neneve 38 pika 2 shkronjat “b”, “c”, “f”, 104 pika 2 e vijues të ligjit nr.97/2016 i ndryshuar**, për të monitoruar si zbatimin, ashtu dhe si kanë ndikuar udhëzimet e përgjithshme në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara dhe efektivitetin e ushtrimit të ndjekjes penale në fushat përkatëse, gjatë vitit 2021, periodikisht i ka kërkuar informacione drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, nëse kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe nëse kanë marrë masa, për koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera, apo për kërkimin e informacionit për ecurinë e procedimeve dhe/ose për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët lidhur me çështje konkrete, apo nxjerrjen e urdhërave për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre, me synim që të sigurojnë efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë, dhe efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurorët e prokurorisë që drejtojnë, duke garantuar pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

ii) Në këtë vështim, në marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorive lidhur me veprimtarinë organizative dhe administrative të tyre, janë evidentuar: -probleme në cilësinë e informimit dhe raporteve që përcillen nga prokuroritë e rretheve për Prokurorin e Përgjithshme, sipas përcaktimeve me aktet ligjore dhe nënligjore, -idhur me ecurinë e veprimtarisë së prokurorive që drejtojnë, të dhënat statistikore periodike, kërkesat për informacion, raportimet periodike

⁷ Shih, aktet normative të PP të miratuara në periudhës Janar- Dhjetor 2021 në Faqen Zyrtare te Prokurorisë së Përgjithshme.

⁸ Shih, po aty, Akte të tjera normative të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm;

⁹ Shih, po aty, marrëveshje bashkëpunimi me institucione te tjera;

tre mujore, etj; -mospërbushje e kërkesave për raportim dhe/ose informim sipas ligjit dhe zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, etj.

iii) Konkretisht, lidhur me informacionet e përcjella nga drejtuesit e prokurorive për masat e marra në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve nënligjore të tjera, evidentohet se:

-Në disa prokurori drejtuesit e prokurorisë sipas ligjit kanë marrë, si masa administrative për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose hartimin e planeve të veprimit për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe masa procedurale për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe/ose kërkuar informacion prokurorëve për ecurinë e çështje konkrete, duke garantuar pavarësinë e tyre;

-Në disa prokurori të tjera, drejtuesit nuk kanë paraqitur të dhëna mbi masa administrative dhe procedurale për zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, të nxjerrë në zbatim të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të KM, apo për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, duke i zbatuar ato pjesërisht apo me mangësi, ndërsa konstatohet gjithashtu se ka mangësi apo vonesa në informimin mbi zbatimin e udhëzimeve dhe ngritjes së infrastrukturës përkatëse administrative për lehtësimin e kushteve për zbatimin e tyre.

iv) Në kuadrin e paraqitjes Prokurorit të Përgjithshëm nga drejtuesit e prokurorive, brenda muajit shkurt 2022, të raportit vjetor mbi ecurinë e punës së prokurorive për vitin 2021, janë verifikuar dhe vlerësuar raportet, nëse paraqitja, forma dhe përmbajtja e tyre është në përfaqje me ligjin¹⁰, dhe me standartet e përcaktuara me aktin normativ apo kërkesat e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe është konstatuar se ka probleme në raportet vjetore të punës nga ana e disa drejtuesve të prokurorive:

-Për këto arsye, në kuadrin e miratimit të përmbajtjes së raportit vjetor të prokurorive përkatëse është kërkuar nga drejtuesit e prokurorive që raporti të plotësohet lidhur me mangësitë e konstatuara dhe të ridërgohet sipas ligjit dhe për publikimin në faqen zyrtare në Prokurorinë e Përgjithshme.

v) Në vështrimin dhe vlerësimin institucional konstatohet dhe vlerësojmë se rregullimi ligjor aktual vështirëson lidhjen organike efektive mes drejtuesve të prokurorive në prokuroritë e shkallës së parë dhe apeleve me Prokurorinë e Përgjithshme, në kuptim të ushtrimit të detyrave ligjore dhe kushtetuese, ndërkohë që angazhimet institucionale që dalin nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave apo në raportet me organizma të tjerë ndërkombëtarë kërkojnë një nivel më të lartë kohezioni institucional. Gjithashtu, vlerësimi i performancës çmojmë se kërkon një përfshirje më të madhe të Prokurorit të Përgjithshëm në procesin e llogaridhënies dhe evidentimit të përgjegjësive në zbatimin e masave administrative e organizative, për sa kohë ka impakt mbi funksionimin në përditshmërinë e aktivitetit të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

III. BASHKËPUNIMI DHE MBËSHTETJA

¹⁰ Shih, pikat 2, 3, 4 e 5 të nenit 50 "Raportimi vjetor te Prokurori i Përgjithshëm" i ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Për çdo strukturë të prokurorisë, bashkëpunimi ndërinstytucional, përfshirja në proceset konsultuese të akteve ligjore e nënligjore dhe mbështetja nga projektet e misionet ndërkombëtare, ka qenë një aspekt i rëndësishëm në zhvillimin e objektivave dhe prioriteteve institucionale dhe ndërinstytucionale të vendit.

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Përgjithshme ka kontribuar me dhënien e opinioneve për reformimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor të dërguar për dhënie mendimi nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Komisioni i Çështjeve Ligjeve dhe Komisioni i Sigurisë të Kuvendit të Shqipërisë, etj. Gjithashtu, kemi qenë proaktivë në identifikimin e nevojave për ndryshim në kuadrin ligjor, duke kërkuar edhe ushtrimin e nismave ligjore në institucionet përgjegjëse, ku përmendim ndryshimet në ligjin organik të prokurorisë për të mundësuar qasjen në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe propozimet për ndryshime në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe ligje të tjera në funksion të sistemit të drejtësisë penale, etj.

Nga ana tjetër, është bashkëpunuar përgjatë vitit 2021 me Projektin EURALIUS V, për identifikimin e gjendjes teknike të sistemit CAMS, përgatitjen e dy sistemeve PRESTO dhe veprimtarinë administrative në PP, si dhe Projektin PAMECA V dhe projektin SIDA, në organizimin e trajnimeve dhe përmirësimin e kuadrit nënligjor që rregullon veprimtarinë e prokurorisë në fusha të caktuara.

1. Bashkëpunimi me SPAK

Bashkëpunimi e koordinimi ndërmjet prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme (SPAK) përgjatë vitit 2021 ka vijuar në zbatimin e Aktit të Koordinimit Institucional, datë 15.12.2020, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK-ut, si në kuadrin e bashkërendimit dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative ndërinstytucionale, ashtu dhe procedurale ndërinstytucionale, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj.

2. Bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë

Bashkëpunimi me ILLD në procesin disiplinor dhe inspektimin e prokurorive është i një rëndësie të veçantë, për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi kushtetuese e ligjore, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të efikasitetit të sistemit të drejtësisë.

Vullneti i të dy institucioneve për të ngritur më tej këtë bashkëpunim dhe për të vendosur kontakte të drejtëpërdrejta për shkëmbimin e informacionit është objekt i marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në datë 05.02.2021.

Në vitin 2021 është kërkuar hetimi disiplinor i 4 (katër) prokurorëve dhe 1 (një) drejtuesi prokurorie si dhe inspektimi tematik i 8 prokurorive.

3. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese

Për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit, një vëmendje të veçantë i është kushtuar, si bashkëpunimit praktik vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë

gjyqësore, ashtu dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstytucional në nivel qendror. Kemi vijuar mbikëqyrjen e masave konkrete për zbatimin e marrëveshjeve dy dhe shumë palëshe për rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale dhe/ose referimeve në prokurori, nxitjen e hetimeve proaktive, nxjerrjen e metodikave hetimore, vendosjen e kontakteve dhe zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve profesionale, masa që çojmë se do të japin rezultate në rritjen e efektivitetit në luftën e përbashkët ndaj kriminalitetit.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA

[shqiptarja.com]